



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



**Drejtoria e Arsimit**

**04 Nr.245**

**Më:31/07/2018**

Duke u bazuar në Ligjin Nr.04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 5 pika c të Ligjit Nr.03/L-068 Për Arsimin në Komunitet në Republikën e Kosovës, Urdhëresës 10/nr.458 të dt.25/07/2018 të lëshuar nga ana e Drejtorit të Inspektoriatit të Arsimit në MASHT, nenit 53, 54 paragrafit 1 nënparagrafit 1.2 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11 paragrafit 2 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.10/2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm të dt.20/07/2018 si dhe Sqarimit të dt.21/07/2018 nga MASHT-i lidhur me UA Nr.10/2018, andaj Drejtoria e Arsimit në Gjakovë mori këtë:

**V E N D I M**

1.Anulohen këto pika të konkursit zyrtar 04/180 i dt.19/07/2018:

1.1 Në Gjimnazin “Hajdar Dushi” në Gjakovë anulohen këto pozita:

- a.Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës angleze me 20 orë mësimi në javë;
- b.Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e psikologjisë me 20 orë mësimi në javë;

1.2 Në shkollën “Nexhmedin Nixha” në Gjakovë anulohet kjo pozitë:

- a.Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës angleze me 20 orë mësimi në javë;

1.3 Në shkollën “Hysni Zajmi” në Gjakovë anulohen këto pozita:

- a.Një (1) fizioterapi;
- b.Një (1) fizioterapi;

1.4 Në shkollën “Kadri Kusari” në Gjakovë anulohen këto pozita:

- a.Një (1) mësimdhënës/e të lëndës së gjuhës angleze me 20 orë mësimi në javë;
- b.Një (1) mësimdhënës/e të lëndës së matematikës me 20 orë mësimi në javë;
- c.Një (1) mësimdhënës/e të lëndës së juridikut me 20 orë mësimi në javë;

1.5 Në shkollën “Mustafa Bakija” në Gjakovë anulohet pozita:

- a.Një (1) mësimdhënës/e të lëndës së gjuhës angleze me 20 orë mësimi në javë;

1.6 Në shkollën “Preng Jakova” në Gjakovë anulohet pozita:

- a.Një (1) mësimdhënës/e të violinës me 20 orë mësimi në javë;

2.Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin nga Drejtori i Arsimit në Gjakovë.

## ARSYETIM

Marrja e këtij vendimi nga ana e Drejtorisë së Arsimit për anulimin e disa nga pozita e konkursit zyrtar 04/180 i dt.19/07/2018 bëhet për shkak të hyrjes në fuqi të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.10/2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm të dt.20/07/2018 i cili parasheh që mësimitdhënësit të cilët janë në marrëdhënie pune në institucionet e arsimit parauniversitar me gradë kualifikimi baçelor trevjeçar me 180 ECTS që kanë më shumë se 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në arsim dhe që kanë licencë të mësimitdhënësit, e vazhdojnë punën në profesionin e tyre deri në përfundimin e vitit shkollor 2020 – 2021. Pas përfundimit të vitit shkollor 2020 – 2021 shpallen konkurset për të gjithë mësimitdhënësit që janë të punësuar në arsimin e mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë, të cilët nuk i plotësojnë kriteret sipas këtij udhëzimi. Drejtoria e Arsimit në Gjakovë ka hapur konkursin zyrtar 04/180 i dt.19/07/2018 në bazë të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr.06/2015 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm i cili tani i shfuqizuar ka paraparë që mësimitdhënësit të cilët janë në marrëdhënie pune në institucionet e arsimit parauniversitar me gradë kualifikimi baçelor (trevjeçar), që kanë më shumë se 3 (tre) vjet përvojë pune në arsim dhe që kanë licencë të mësimitdhënësit vazhdojnë punën në profesionin e tyre edhe për 3 (tre) vite shkollore, me qëllim që gjatë kësaj periudhe të arrijnë nivelin e kualifikimit të paraparë sipas këtij normativi. Pas përfundimit të vitit shkollor 2017 – 2018 shpallet konkursi për vende të lira për të gjithë kandidatët që nuk i plotësojnë kriteret e kualifikimit. Po ashtu në bazë të Urdhërësës me Referencë 10/Nr.458 i dt.25/07/2018 të lëshuar nga ana e Departamentit të Inspektoratit të Arsimit në MASHT është kërkuar nga ana Drejtorive të Arsimit në Kosovë që të anulojnë konkurset për vendet e lira të punës që janë hapur në kundërshtim me udhëzimet administrative të MASHT-it në mënyrë që ato t'i anulojnë dhe të veprojnë sipas legjislacionit në fuqi.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur mund të bëjë ankesë në afat prej 8 ditësh, në Sektorin e Inspektoriatit të Arsimit në Gjakovë.

**Me vendim njoftohen:**

- Kandidatët të cilët kanë aplikuar në konkursin zyrtar 04/180/ i dt.19/07/2018
- Sektorit të Inspektoratit të Arsimit në Gjakovë
- Shërbimit juridik
- Arkivit

